



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR GJIROKASTER



Nr 183-10 AKTIT  
Data e regj 27.12.2010

NR 10 VENDIMIT  
Date 08.02.2011

V E N D I M  
“ NE EMER TE REPUBLIKES”

**Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokaster e per bere prej:  
GJYQAR ARQILE BASHO**

A sistuar nga sekretare Ervehe Tosuni, ne gjykate, sot ne daten 08.02.2011,  
shqyrtoi ceshtjen penale nr 183-10 akti date 27.12.2010 qe u perket :

**ANKUES** : Namik Malaj, i biri Qamilit, dt/lindja 1959, lindur ne Vlore dhe  
banues ne Tirane, me karte identiteti 024962311,  
-perfaqesuar ne gjykim nga av. Kujtim Idrizi.

**KUNDER** : Kundershtimin e Vendim Sekuestrimi dt 20.10.2010 , te  
Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Gjirokaster.

**ME PJESEMARRJEN** : Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Gjirokaster – prokuror  
Gjon Fusha.

**OBJEKT**: Shfuqizimin e Vendim Sekuestrimi duke vendosur heqjen e  
mases se sekuestros mbi automjetin me targa TR 7053 M dhe kthimin e  
mjetit Shoqerise « ROGI-2001 » me administrator Namik Malaj.

**Faza Ligjore**: Nenet 212, 217, 218 dhe 415 K.Pr.Penale.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyesor te ceshtjes palet kerkuan:

Ankuesi: - Shfuqizimin e Vendimit dhe kthimin e mjetit.

Prokurori: - rrezimin e ankimit.

Gjykata pasi degjoi palet, shqyrtoi aktet e dosjes gjyqesore dhe ceshtjen ne teresi:

V E R E N



Ankuesi Namik Malaj, me cilesine e administratorit te shoqerise, kerkon shfuqizimin e Vendim Sekuestrimi dt 20.10.2010. te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Gjirokaster dhe kthimin e mjetit te sekuestruar me targe TR 7053 M pronarit, shoqerise ROGI-2001.

**Nga shqyrtimi gjyqesor i ceshtjes rezultoi se:**

Prokuroria e Rr.Gj.Gjirokaster ka nisur procedimin penal ndaj perfaqesuesve te Shoqerise "ALB 2005", me adrese autostrada Durres Tirane, Nako Pashaj, Ilia Cone, Deli Zenelaj, Edison Alili dhe Aleksander Bala, per vepren penale "Kontrbande me mallra te tjere", kryer ne bashkepunim, parashikuar nga nenet 174 e 25 te K.Penal si dhe ndaj disa punonjesve te Doganes Kakavie akuzuar per vepren penale te parashikuar nga nenet 175 e 25 te K.Penal. Nga rrethanat e hetimit ka rezultuar se shoqeria "Veshi shpk" me administrator shtetasin Pandi Veshi, me mjetin ne pronesi te saj me targa KO 4233 B me drejtues shtetasin Ilia Cone, ka kryer transportimin e mallrave, pluhur lares dhe shampo, per llogari te shtetasve Edison Alili dhe Aleksander Bala. Ne mesnaten e dates 31.07.2010 duke u gdhire data 01.08.2010, mjeti me targa KO ka ardhur deri ne Dogane ne territorin grek, aty ka ndaluar per shkak te nje defekti teknik, ngarkesa tij, sipas deklarimeve te personave gjate hetimit, eshte zhvendosur ne automjetin me targe TR 7053 M te drejtuar nga shtetasi Edison Alili dhe eshte futur ne territorin shqiptar. Te nesermen mjeti me targa KO ka rregulluar defektin dhe ka kaluar ne Dogane ku pas konstatimit se nuk ishte i plumbosur dhe nuk kishte dokumentacionin e mallit, eshte ndaluar nga autoritetet doganore dhe eshte proceduar me hetimin.

Ne keto rrethana Prokurori ka marre Vendimin e Sekuestros ndaj mjetit me targa TR ne pronesi te ankuesit ne te cilin eshte disponuar: "1.Sekuestrimin e mjetit te tipit kamion me targe TR 7053 M mjet ne pronesi te Shoqerise "ROGI-2001" me administrator shtetasin Namik Malaj, .... 2.Lenien ne ruajtje te kamionit ... shtetasit Namik Qamil Malaj..."

Ne keto rrethana ankuesi kundershkon vendimin e prokurorit duke parashtruar:  
-nuk ka ndonje procedim penal ndaj shoqerise "ROGI-2001" apo ndaj punonjesve te saj. Rrethanat e hetimit kane konkluduar per personat qe dyshohen per kryerjen e vepres penale dhe asnje nga personat e shoqerise nuk eshte i dyshuar.

-mjeti i eshte dhene ne perdorim drejtuesit Nako Pashaj me kontrate ligjore si i punesuar prane shoqerise. Perdoruesi deklaroi ne menyre te ligjshme se ne perudhen 25.07 deri 03.08 2010 mjeti eshte perdorur prej tij dhe ai nuk ka qene i Doganen Kakavie.

- organi i hetimit, megjithese kaloi nje kohe relativisht e gjate, akoma nuk ka zbardhur rrethanat per te cilat dyshohet se mjeti yne eshte perdorur per te kryer kontrabande.

-vendosja e sekuestros mbi mjetin penalizon Shoqerine dhe punonjesit e saj me dem ekonomik qe rrjedh nga bllokimi i mjetit, me pamundesine e funksionimit



normal te aktivitetit ne rrethanat kur punonjesit e shoqerise dhe shoqeria nuk kane lidhje me procedimin penal dhe rrethant e perdorimit te mjetit nuk po provohen.

Prokurori i ceshtjes ne gjykim kundershtoi ankimin e ankuesit me arsyetimin se ne vleresimin e tij, hetimi i ceshtjes vazhdon, vendimi i sekuestros eshte marre ne baze te ligjit dhe duhet te qendroje ne fuqi deri ne perfundim te ceshtjes penale.

**Ne lidhje me parashtrimet e paleve dhe percaktimin e ligjit gjykata vlereson se:**

- Neni 208 K.Pr.Penale percakton: "1.Gjyqtari ose prokurori disponojne me vendim te arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe te sendeve qe lidhen me vepren penale kur ato jane te domosdoshme per vertetimin e fakteve" ...

-Neni 212 percakton te drejten e ankimit te pronarit te sendit te sekuestruar kunder vendimit te sekuestrimit.

-Neni 217 K.Pr.Penale percakton: "1.Kur nuk eshte e nevojshme mbajtja e sekuestros per qellime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij qe i takojne edhe para se te merret vendimi perfundimtar. ..."

-Neni 218 K.Pr.Penale percakton: "1.Gjykata vendos kthimin e sendeve te sekuestruara kur nuk ka dyshim per perkatesine e tyre."....

Rrethanat e ceshtjes rezultojne:

- vendimi i sekuestrimit eshte marre ne rrethanat e dyshimeve se automjeti eshte perdorur per te kryer kontrabante me mallra te tjere. Keto dyshime, megjithe hetimet e zhvilluara, nuk jane vertetuar nga organi i akuzes.
- nuk rezultojne nevoja te mbajtjes se sekuestros mbi mjetin per qellime prove. Me automjetin nuk lidhen te dhena qe perbejne prove per vertetime faktesh te ngjarjes penale.
- ne ceshtjen penale te ushtruar nga prokurori nuk rezultojne rrethana te sigurimit te padise civile, sipas nenit 217/2 te K.Pr.Civile.
- perkatesia e automjetit objekt konflikti provohet me aktet e pronesise se mjetit dhe kjo perkatesi nuk permban dyshime.

Mbi percaktimet ligjore te sipercituara dhe te rrethanave te ceshtjes Gjykata vlereson se nuk rezultojne nevoja te mbajtjes se sekuestros mbi mjetin per qellime prove, mbajtja e mjetit nen sekuestro nuk rezulton te jete per ndonje qellim hetimor, mjeti nuk permban ne gjendjen fizike te tij ndonje prove per nevoja te hetimit, nuk ka dyshime per perkatesine e mjetit, Shoqeria ROGI-2001 dhe punonjesit e saj nuk lidhen me vepren penale per te cilen hetohet dhe rrjedhimisht nuk mund te penalizohen me dem ekonomik nga mosperdorimi i mjetit.

Gjykata kokludon se ankimi i ankuesit kunder vendimit te sekuestros ndaj automjetit ne pronesi te tij (shoqerise) eshte i bazuar ne ligj dhe ne prova dhe duhet te pranohet duke vendosur heqjen e sekuestros dhe kthimin e automjetit.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata ne baze te neneve 217 e 218 te Kodit te Procedures Penale,

**VENDOSI**

- Pranimin e ankimit.
- Shfuqizimin e Vendim Sekuestro dt 20 Tetor 2010 te Prokurorise Rr.Gj. Gjirokaster mbi sekuestrimin e mjetit tip kamion me targa TR 7053 M. Kthimin e mjetit ne pronesi te pronarit Shoqeria «ROGI-2001 »
- Shpenzimet gjyqesore sic jane kryer.
- Kunder ketij vendimi mund te behet apelim ne Gjykatën e Apelit Gjirokaster brenda 10 diteve.
- U shpall ne Gjirokaster sot dt. 08.02.2011.

**SEKRETARE**  
**Ervehe Tosuni**



**G J Y Q T A R**  
**ARQILE BASHO**



Ky vendim ka mare forme te prere pa u ankimuar ne date 18.2.2011

KANCELARE  
Dhurata Abazi



Me shkresen e dates 31.3.2011 vendimi ju percoll Prokurorise se Rrethit Gjirokaster.

KANCELARE  
Dhurata Abazi

